



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK

Nr. 19/9 .Prot

KONTRATË PUNË CIVILE
“RIKONSTRUKSION I RRJETIT RRUGOR TË QYTETIT SHIJAK”

Në Shijak, sot më datë 29 / 05 /2017, lidhet kjo kontratë ndërmjet:

PALËVE KONTRAKTUESE:

AUTORITETI KONTRAKTOR:

BASHKIA SHIJAK, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Ardian Kokomani .
Adresa: Lagja “Erzen” Shijak
Tel/fax: 057122152
NIPT: K 51703504 A

KONTRAKTORI

A.L-ASFALT sh.p.k përfaqësuar nga Administratori Z. Luan Mema
Adresa: Pranë kryqëzimit 4 Rrugët, Xhafzotaj
Tel/fax: 0684018777
NIPT : K 81511508 A
Licence: NZ. 5830/9 datë 08.10.2015

KONTRAKTORI

“EURONDËRTIMI 2000” sh.p.k përfaqësuar nga Përfaqësuesi ligjor Z.Qani Saraçi
Adresa: Njësia bashkiake nr.7, Rr.Kavajës, Pallati 117, Shk.1 Kati 2, Ap.2, Tiranë
Tel/fax: 0684000907
NIPT : K02003001O
Licence: NZ. 3584/11 datë 05.05.2016

Palët bien dakort për sa më poshtë:

NENI 1
OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 - Objekti i kësaj kontrate është “Rikonstruksioni i rrjetit rrugor të qytetit Shijak”, si më poshtë:

- Rikualifikim i Rr.Sul Zalla

BASHKIA SHIJAK

A.L-ASFALT shpk & EURONDERTIMI 2000 shpk



- Rikualifikim i Rr.Gani Keta
- Rehabilitimi i sheshit Lugina (shtesa)
- Rikonstrukcion i degëzimit të rrugës Naim Frashëri
- Rikonstrukcion i rrugës "16 Shtatori" dhe degëzimet

NENI 2

DOKUMENTAT E KONTRATËS

2.1 - Dokumentat e mëposhtme do të përbëjnë kontratën midis *Autoritetit Kontraktor* dhe *Kontraktorit*, secili dokument do të konsiderohet si pjesë integrale e kontratës:

- Formulari i sigurimit të kontratës, në shumën 10% e vlerës së ofertës.
- Oferta ekonomike dhe Preventivi të paraqitura nga *Kontraktori* dhe të pranuar nga *Autoriteti Kontraktor*.

2.2 - Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në KPK dhe KVK.

2.3 - Dokumentat e lartpërmendura në perfundim të kontratës mbeten pronë e *Autoritetit Kontraktor*.

NENI 3

ÇMIMI I KONTRATËS

3.1 - Çmimi i kontratës është çmimi i ofruar në ofertën e *Kontraktorit* dhe i pranuar nga *Autoriteti Kontraktor*, me vlerë të përgjithshme prej **82.806.230** (tetëdhjetë e dymilionë e tetëqind e gjashtëmijë e dyqind e tridhjetë) **lekësh pa TVSH** ose **99.367.476** (nëntëdhjetë e nëntëmilionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) **lekësh me TVSH**, i detajuar si më poshtë:

- **Rikualifikim i Rr.Sul Zalla** me vlerë të përgjithshme prej **12.873.500** (dymbëdhjetëmilionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tremijë e pesëqind) **lekë pa TVSH** ose **15.448.200** (pesëmbëdhjetëmilionë e katërqind e dyzetë e tetëmijë e dyqind) **lekë pa TVSH**.
- **Rikualifikim i Rr.Gani Keta** me vlerë të përgjithshme prej **8.051.660** (tetëmilionë e pesëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH** ose **9.661.992** (nëntëmilionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**.
- **Rehabilitimi i sheshit Lugina (shtesa)** me vlerë të përgjithshme prej **19.476.170** (nëntëmbëdhjetëmilionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë) **lekë pa TVSH** ose **23.371.404** (njëzetë e tremilionë e treqind e shtatëdhjetë e njëmijë e katërqind e katër) **lekë pa TVSH**.

- Rikonstrukcion i degëzimit të rrugës Naim Frashëri me vlerë të përgjithshme prej 1.735.000 (njëmilionë e shtatëqind e tridhjetë e pesëmijë) lekë pa TVSH ose 2.082.000 (dymilionë e tetëdhjetë e dymijë) lekë pa TVSH
- Rikonstrukcion i rrugës “16 Shtatori” dhe degëzimet me vlerë të përgjithshme prej 40.669.900 (dyzetëmilionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind) lekë pa TVSH ose 48.803.880 (dyzetë e tetëmilionë e tetëqind e tremijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

NENI 4 **KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

4.1 - Kjo kontratë do të realizohet brenda 143 (njëqind e dyzetë e tre) ditëve nga dita e nënshkrimit të saj nga palët në përputhje me grafikun e hartuar .

4.2 - Për çdo ndryshim në grafik *Kontraktori* duhet të njoftojë me shkrim *Autoritetin Kontraktor*.

NENI 5 **MËNYRA DHE AFATET E PAGESËS**

5.1 - Pagesa duhet të kryhet pas marrjes në dorëzim të objektit, nga grupi i eksperteve i ngritur për marrjen në dorëzim të punës së kryer dhe brenda 30 ditëve nga lëvrimi i fondit nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

5.2 - Pagesa do të kryhet me urdhër shpenzimi në llogarinë e *Kontraktorit* (sipas kontratës së bashkëpunimit dhe prokurës së posaçme) kundrejt paraqitjes zyrtare të faturës tatimore të shitjes.

5.3 - Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e *Autoritetit Kontraktor*.


5.4 - Pagesat bëhen në monedhën shqiptare.

5.5 - *Kontraktori* është i detyruar të paguajë vetë të gjitha taksat në bazë të ligjeve në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.

NENI 6 **SIGURIMI I KONTRATËS**

6.1 - Brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, *Kontraktori* duhet t'i dorëzojë *Autoritetit Kontraktor* sigurimin e kontratës. në vlerën 10% e vlerës së ofertës, në formën e policës së sigurimit.

6.2 - Dështimi për të dhënë brenda 5 ditëve , sigurimin e kontratës në formën dhe në shumën e kërkuar do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe sekuestrimin e sigurimit të ofertës së *Kontraktorit*.



6.3 - Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet *Autoritetit Kontraktor* si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i *Kontraktorit* në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

6.4 - Sigurimi i kontratës do t'i kthehet *Kontraktorit* jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve.

NENI 7 ***GARANCIA E DEFEKTEVE***

7.1 - Periudha e garancisë së defekteve është 1 vit nga përfundimi i punimeve.

7.2 - 5 % (pesë përqind) e vlerës së sigurimit të kontratës do të mbahet si garanci për efekt cilësie (defektesh) të punimeve për një periudhë 1 vjeçare dhe do t'i kthehet *Kontraktorit* në përfundim të periudhës së garancisë.

NENI 8 ***KONTRAKTORI QE KRYEN PUNIMET E NDËRTIMIT***

8.1 - Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe të përfundojë punimet brenda afatit të mbarimit në përputhje me grafikun e punimeve dhe specifikimet teknike .

NENI 9 ***NGRITJA E KANTIERIT DHE SIGURIMI TEKNIK***

9.1 - *Kontraktori* mban përgjegjësi për ngritjen e kantierit të ndërtimit, sistemimin dhe rregullimin e vendit të punës duke paraqitur të gjitha planet për ngritjen e kantierit tek drejtuesi i punimeve për shqyrtim dhe miratim.

9.2 - *Kontraktori* do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

NENI 10 ***TESTIMET DHE INSPEKTIMET***

10.1 - *Kontraktori* mban përgjegjësi për zbatimin e kontratës me cilësi dhe në afat. Ai duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara për zbatimin e kontratës.



NENI 11

RAPORTIMI I GRAFIKUT TË ZBATIMIT

11.1- Drejtuesi i punimeve ka të drejtë të vendosë për çështjet e kontratës midis *Autoritetit Kontraktor* dhe *Kontraktorit*.

11.2- Me lidhjen e kontratës *Kontraktori* duhet ti paraqesë drejtuesit të punimeve një program plani për aktivitetet e punimeve që do të kryhen në kantier.

NENI 12

PARALAJMËRIMI NË KOHË

12.1 - *Kontraktori* duhet të lajmërojë në kohë drejtuesin e punimeve për ngjarje e rrethana specifike që mund të ndodhin apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

NENI 13

KONTROLLI I CILËSISË

13.1 - *Kontraktori* është plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë në zbatimin e kontratës.

13.2 - *Kontraktori* me lidhjen e kontratës duhet ti paraqesë drejtuesit të punimeve një plan kontrolli të cilësisë.

13.3 - Drejtuesi i punimeve duhet të kontrollojë *Kontraktorin* dhe të njoftojë atë për defektet e konstatuara. Me marjen e njoftimit me shkrim *Kontraktori* është i detyruar ti korrigojë defektet brenda afatit të parashikuar nga drejtuesi i punimeve.

13.4 - Nëse defektet nuk korigjohen nga *Kontraktori* brenda afatit të parashikuar në njoftim, drejtuesi do të llogarisë koston e korrigjimit dhe kjo shumë do të mbahet nga pagesa e bërë për dhe në emër të *Kontraktorit*.

13.5 - Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të *Autoritetit Kontraktor*.

NENI 14

PËRGJEGJËSITË E AUTORITETIT KONTRAKTOR

14.1 - *Autoriteti Kontraktor* është përgjegjës nga afati i fillimit deri në afatin e realizimit të plotë të kontratës për:

- vdekje, dëmtim personal, humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, goftë edhe e ligjshme nga ai vet ose nga çdo person i punësuar/ kontraktuar prej tij, përveç *Kontraktorit*.



- dëmtim të punimeve , materialeve apo pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e *Autoritetit Kontraktor*.

NENI 15 **PËRGJEGJËSITË E KONTRAKTORIT**

15.1 - Nga afati i fillimit deri në afatin e realizimit, *Kontraktori* do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga *Autoriteti Kontraktor* sipas Nenit 18 të kësaj kontrate.

NENI 16 **GARANCITË**

16.1 - *Kontraktori* duhet të garantojë se materialet e trupëzuara janë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit.

16.2 - *Kontraktori* garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mos veprim i këtij të fundit apo të shkaktuara nga kryerja e punimeve në kushte normale përdorimi.

NENI 17 **VONESA NË ZBATIM DHE ZGJATJA E AFATIT**

17.1 - Me nënshkrimin e kësaj kontrate *Kontraktori* duhet të fillojë menjëherë zbatimin e saj.

17.2 - Me përjashtim të rasteve kur *Autoriteti Kontraktor* është dakort për zgjatjen e afateve të kontratës , ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse *Kontraktori* dështon në dorëzimin e objektit brenda afatit të specifikuar në kontratë.

17.3 - *Autoriteti Kontraktor* mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë *Autoriteti Kontraktor* duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

17.4 - Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

NENI 18 **NDRYSHIMI I POROSISË**

18.1 - Kushtet e kontratës mund të jenë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi të kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga *Autoriteti Kontraktor* dhe kontraktori.

BASHKIA SHIJAK

A.L-ASFALT shpk & EURONDERTIMI 2000 shpk



18.2 - Ndërtime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

18.3 - Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

18.4 - Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrëveshjes.

NENI 19 FORCAT MADHORE

19.1 - *Kontraktori* nuk mban përgjegjësi nëse dështimi në përmbushjen e detyrimeve të kontratës ose vonesat për zbatim e saj vijnë si pasojë e ngjarjeve të forcës madhore.

19.2 - Nëse ndodh një situatë e forcës madhore, *Kontraktori* duhet të njoftojë menjëherë *Autoritetin Kontraktor*. *Kontraktori* duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

NENI 20 NDËRPRERJA E KONTRATËS

20.1 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën kur *Kontraktori* ndërpret punën për 10 ditë nëse kjo nuk është e parashikuar ose e autorizuar nga drejtuesi i punimeve.

20.2 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse, *Kontraktori* dështon pa shkaqe të arsyeshme në kryerjen e punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë apo brenda zgjatjes së dhënë ose dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Në këtë rast *Autoriteti Kontraktor* duhet t'i japë *Kontraktorit* njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim si dhe t'i japë atij 15 ditë kohë të ndreqë mplotësimin, me përjashtim të rasteve kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme.



20.3 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse *Kontraktori* falimenton ose bëhet i pafatë të paguajë. Në këtë rast *Autoriteti Kontraktor* duhet ti japë *Kontraktorit* njoftim me shkrim për ndërprejen.

20.4 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për shkak të interesit publik. Në këtë rast *Autoriteti Kontraktor* duhet të lajmërojë me shkrim *Kontraktorin* për ndërprerjen dhe duhet t'i paguajë atij (*Kontraktorit*) të gjitha punimet e kryera përpara ndërprerjes së kontratës si dhe do t'i kërkojë të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

20.5 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën nëse *Kontraktori* dështon për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm nga dita e njoftimit të drejtuesit të punimeve.

NENI 21 KOMUNIKIMI

21.1 - Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim.

21.2 - Njoftimi është efektiv vetëm pasi t'i dorëzohet palës tjetër.

NENI 22 LLOGARITJA E AFATEVE

22.1- Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

NENI 23 BAZA LIGJORE

23.1 - Kjo kontratë është hartuar në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe Dokumenteve Standarte të Tenderit të miratuar nga APP.

23.2 - Për çdo mungesë parashikimi në këtë kontratë, palët do të referohen KPK dhe KVK, që janë pjesë e Dokumentave Standarte të Tenderit.





NENI 24
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

24.1- Palët nënshkruese të kontratës duhet të bëjnë përpjekje që mosmarrëveshjet të zgjidhin me mirekuptim ndërmjet tyre, në të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, palët do të drejtohen gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

NENI 25
VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

25.1- Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga dita e nënshkrimit nga palët.

25.2 - Kontrata përpilohet në 6 (pesë) kopje, me vlerë dhe përmbajtje të njëjtë juridike, nga të cilat 4 (katër) kopje i mban *Autoriteti Kontraktor* dhe 2 (dy) kopje i mban *Kontraktori*.

PALËT KONTRAKTUESE:

AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA SHIJAK
KRYETARI

ARDIAN KOKOMANI

KONTRAKTORI
“AL-ASFALT” sh.p.k
PËRFAQËSUESI LIGJOR


LUAN MEMAJ



KONTRAKTORI
EURO NDËRTIMI 2000sh.p.k
PËRFAQËSUESI LIGJOR


QANI SARACI

